



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:025717

Datë: 13.09.2018

Numri i dokumentit: 00125526

P.nr.894/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. S. nga fshati D., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1820/2017, të datës 22.12.2017, e cila është plotësuar me datë 14.05.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 13.09.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H. S., nga i ati A, e ëma Sh, e gjinisë M, data e lindjes ... në fshatin D., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar, baba i 4 (katër) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse nga data e pa vërtetuar e gjer me datën 09.08.2017, në shtëpinë e tij e cila ndodhet në fshatin D., Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim vjedhje, pa njëjsor elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik kështu që ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, ashtu që të dëmtuarës K.-D. Gjakovë i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 299.05 Euro, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të K.-D.në Gjakovë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 320 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €uro dhe duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari H. A. S., nga fshati D., Komuna e Gjakovës, që të dëmtuarës K.-D. në Gjakovë, t'ia kompensoi në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 299.05 €uro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 30 (tridhjetë) €uro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) €uro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1820/2017, të datës 22.12.2017, e plotësuar me datë 14.05.2018, kundër të akuzuarit H. S., nga fshati D., Komuna e Gjakovës, ku fillimisht të akuzuarin e kishte akuzuar për shkak të veprës penale nga neni 61 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës nr.05/L-85. Prokuroria Themelore në Gjakovë, përmes parashtrësës së datës 14.05.2018, ka bërë përmirësimin e aktakuzës duke e bërë rikualifikimin e veprës penale nga neni 61 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës nr.05/L-85 në veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit H. S. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari H. S., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se është penduar për këtë veprim dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla, është e vërtetë që e kam lidhur kabllo mirëpo për këtë kam bërë kërkesë tek K. por ata nuk kanë ardhur dhe jam detyruar që ta lidh vetë dhe kjo lidhje ka qenë 5 ditë para se të vijë kontrolli ku edhe është gjetur edhe kabllo.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari H. S., nga data e pa vërtetuar e gjer me datën 09.08.2017, në shtëpinë e tij e cila ndodhet në fshatin D., Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim vjedhje, pa njehsor elektrik përmes kabllos është lidhur direkt në rrjetin elektrik kështu që ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, ashtu që të dëmtuarës K.-D. Gjakovë i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 299.05 €uro, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të K.-D. në Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit

mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuari: së është baba i 4 (katër) fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, të ardhurat i fiton kryesisht përmes ndihmës së fëmijëve të tij të cilët jetojnë në Kroaci, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, do të jetë më i kujdesshëm, faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në bazë të nenit 463 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që i akuzuari H. A. S., nga fshati D., Komuna e Gjakovës, t'ia kompensoi të dëmtuarës K.-D. në Gjakovë në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 299.05 €uro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.894/17, me datë 13.09.2018

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Mentor Bajraktari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.